

AKT THEMELIMI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ AGENZIA MIR SH.P.K”

Ne Durres sot me date 23.02.2024 (dymijeejzetekater), ortaket:

1. Ilaria Nurchi qytetare italiane , lindur ne Rome me 23 tetor 1967 me banim ne Treviso , rruga Via Luigi Santorio 5, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar me karte identiteti italiane nr. YA 87123394, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR
2. Mirco Ruaro, qytetar Italian, lindur ne Schio (VI), me 22 qershor 1960 me banim ne Via Carlo Forlanini, N.23 Valdagno, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar me pasaporten nr. YA 8303997, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR SH.P.K
3. Pierluigi Poletti qytetar Italian lindur ne Milano me date 27 dhjetor 1949, me banim ne Santa Maria della Versa ne rrugen Via Francesco Crispi 200 Itali, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar me pasaporten nr. YB 7530828, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR SH.P.K

të cilët, firmosin aktin e themelimit me termat si me poshte vijon :

NENI 1

Emri dhe forma e shoqerise

1.1 Shoqeria krijohet si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “AGENZIA MIR Sh.p.k” , qe ketu e meposhte do te quhet “ Shoqeria”.

NENI 2

Themelimi

2.1 Shoqeria do te themelohet sipas ligjit nr.9901 date 17.01.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.


2.2 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe kete Akt themelimi.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen : Durres, Lagjia nr.17, Spitalle, Z.K.8517, Godine me nr pasurie nr.173/217.





3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise si dhe te hape ose te mbylle zyra ne vende te ndryshme pervec selise se Shoqerise Brenda territorit shqipetar.

NENI 4

Objekti

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin si me poshte vijon:

Shoqeria ka per objekt konfeksionimin dhe prodhimin e artikujve te veshmbathjes te cfaredo tipi dhe cilesie , duke perfshire ate te jashtem, kemishat, aksesoret e veshjeve dhe te brendshme.Fasoneri .

Mund te permbushë, ne rruge jo kryesore, te gjitha operacionet tregtare, industriale, te letrave me vlere dhe te pasurive te patundshme te cdo lloji, duke perfshire leshimin e garancive reale dhe personale ne favor te vetes ose te te treteve.

Pjesemarrja (jo per qellim shitje) ne investime ne kompani te tjera , institucione , shoqata ,ndermarrje, organizata ne pergjithesi, te formuara ose duke u formuar me objekt te ngjashem, te perafert ose te lidhura , te cilat do te vleresohen nga administrator te nevojshem ose te volitshem per arritjen e permbushjes se objektit te shoqerise, te kryera ne perputhje me normat ligjore te fushes, dhe gjithmone nese jane te shfrytezueshme ne permbushjen e objektit te shoqerise dhe nuk ndermerren per ceshtje qe i takojne rregullimeve publike.

Perjashtohen shprehimisht nga aktivitetet e objektit te shoqerise,aktivitetet te cilat per nga natyra apo per nga menyra e ushtrimit jane te rezervuara per bankat dhe per te gjithe ndermjetesit financiare ne pergjithesi se dhe ne cdo rast kur aktiviteti ke te beje me mbledhjen e kursimeve te personave ose mbledhjen e kursimeve publike.

4.2 Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji I zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

NENI 5

Kohezgjatja

5.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te Regjistrin Tregtarprane Qendres Kombetare te regjistrimit.

NENI 6

Ortakët dhe themeluesit e Shoqerise jane

1. Ilaria Nurchi qytetare italiane , lindur ne Rome me 23 tetor 1967 me banim ne Treviso , rruga Via Luigi Santorio 5, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , , identifikuar me karte identiteti italiane nr. YA 87123394, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR SH.P.K
2. Mirco Ruaro , qytetar Italian, lindur ne Schio (VI), me 22 qershor 1960 me banim ne Via Carlo Forlanini, N.23 Valdagno, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , ,





identifikuar me pasaporten nr. YA 8303997, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR SH.P.K

3. Pierluigi Poletti qytetar Italian lindur ne Milano me date 27 dhjetor 1949, me banim ne Santa Maria della Versa ne rrugen Via Francesco Crispi 200 Itali, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, , identifikuar me pasaporten nr. YB 7530828, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR SH.P.K

NENI 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 50.0000 (pesedhjetë mijë Leke , I ndare ne 3 kuota. 1 kuote per secilin.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

1. Zj. Ilaria Nurchi në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 25.000 Leke në kapitalin themeltar.
2. Z. Mirco Ruaro, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 48% të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 24.000 leke në kapitalin themeltar.
3. Z. Pierluigi Poletti, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 2% të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 1.000 leke në kapitalin themeltar

7.2 Kapitali I Shoqerise perbehet teresisht nga kontribute ne para dhe zoterohet nga 3 ortakët e shoqerise.

7.3 Kuotat me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe pas ushtrimit te se drejtes se parablerjes ndaj ortakëve te tjere te Shoqerise, jane lirisht te transferueshme tek cdo individ ose person juridik nepermjet kontrates se shitblerjes, trashegimise, dhurimit ose nepermjet cdo menyre tjeter dhe forme te parashikuara nga ligji.

NENI 8

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

8.1 Aambleja e Pergjithshme, ne perputhje me ligjet shqiptare, mund te marre, por pa u kufizuar , vetem ne vendime te ndryshimin e statutit, bashkimit ne shoqeri te tjera , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, transferimin e plote ose te pjesshem te kuotave, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, emerimin e ekspertit kontabel, miratimin e llogarive vjetore dhe te pasqyrave financiare, likuidimin e shoqerise, emerimin e likuidatorit.



NENI 9

Administrimi i Shoqerise

9.1 Administratori shoqerise do te jete:

- Ilaria Nurchi qytetare Italiane , lindur ne Rome me 23 Tetor 1967 me banim ne Treviso , rruga Via Luigi Santorio 5, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , , identifikuar me karte identiteti italiane nr. YA 87123394

9.2 Administratori emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecar, me te drejte riemerimi. Administratori shkarkohet nga detyra , ne cdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

9.3 Administratori i Shoqerise do te veproje marrjen e vendimeve dhe akteve te parashikuara ne ligj dhe statutin e Shoqerise.

NENI 10

Ligji i Zbatueshem

10.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me ligjin shqiptar.

10.2 Cdo konflikt qe mund te linde mes ortakeve te Shoqerise do te zgjidhem me mirekuptim ne rast te kundert, mosmarreveshja do te jete objekt I zgjidhjes nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Gjygesor Durres.

ORTAKET THEMELUES

Zj. Ilaria Nurchi

ILARIA NURCHI

Z. Mirco Ruaro

MIRCO RUARO

Z. Pierluigi Poletti

PIERLUIGI POLETTI

Perkithen





STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ AGENZIA MIR SH.P.K”

NENI 1

Emri dhe forma e shoqerise

1.1 Shoqeria krijohet si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “AGENZIA MIR Sh.p.k”, qe ketu e meposhte do te quhet “ Shoqeria”.

NENI 2

Themelimi, personaliteti juridik

2.1 Shoqeria do te themelohet sipas ligjit nr.9901 date 17.01.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

2.2 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe kete Akt themelimi.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen :

Durres, Lagjia nr.17, Spitalle, Z.K.8517, Godine me nr pasurie nr.173/217.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise si dhe te hape ose te mbylle zyra ne vende te ndryshme pervec selise se Shoqerise Brenda territorit shqiptar.

NENI 4

Kohezgjatja

7.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te Regjistrin Tregtarprane Qendres Kombetare te regjistrimit.

NENI 5

Objekti

6.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin si me poshte vijon:

Shoqeria ka per objekt konfeksionimin dhe prodhimin e artikujve te veshmbathjes te cfaredo tipi dhe cilesie , duke perfshire ate te jashtem, kemishat, aksesoret e veshjeve dhe te brendshme.Fasoneri

Mund të permbushë, në rrugë jo kryesore, të gjitha operacionet tregtare, industriale, të letrave me vlerë dhe të pasurive të patundshme të çdo lloji, duke përfshirë leshimin e garancive reale dhe personale në favor të vetes ose të tjetër.

Pjesëmarrja (jo për qëllim shitje) në investime në kompani të tjera, institucione, shoqata, ndërmarrje, organizata në përgjithësi, të formuara ose duke u formuar me objekt të ngjashëm, të përafert ose të lidhura, të cilat do të vlerësohen nga administratori të nevojshëm ose të volitshëm për arritjen e përbushjes së objektit të shoqërisë, të kryera në përputhje me normat ligjore të fushës, dhe gjithmone nëse janë të shfrytëzueshme në përbushjen e objektit të shoqërisë dhe nuk ndermerren për çështje që i takojnë rregullimeve publike.

Perjashtohen shprehimisht nga aktivitetet e objektit të shoqërisë, aktivitetet të cilat për nga natyra apo për nga mënyra e ushtrimit janë të rezervuara për bankat dhe për të gjithë ndërmjetësit financiarë në përgjithësi dhe në çdo rast kur aktiviteti ke të bëjë me mbledhjen e kursimeve të personave ose mbledhjen e kursimeve publike.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

NENI 6

Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë

1. Ilaria Nurchi qytetare italiane, lindur në Rome më 23 tetor 1967 me banim në Treviso, rruga Via Luigi Santorio 5, madhore e me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti italiane nr. YA 87123394, në çelësinë e ortakut të shoqërisë AGENZIA MIR
2. Mirco Ruaro, qytetar Italian, lindur në Schio (VI), më 22 qershor 1960 me banim në Via Carlo Forlanini, N.23 Valdagno, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr. YA 8303997, në çelësinë e ortakut të shoqërisë AGENZIA MIR SH.P.K
3. Pierluigi Poletti qytetar Italian lindur në Milano më datë 27 dhjetor 1949, me banim në Santa Maria della Versa në rrugën Via Francesco Crispi 200 Itali, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën nr. YB 7530828, në çelësinë e ortakut të shoqërisë AGENZIA MIR SH.P.K


NENI 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 50.0000 (pesëdhjetë mijë) Leke, i ndarë në 3 kuota nga 1 kuote për secilin.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

Zj. Ilaria Nurchi në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 25.000 Leke në kapitalin themeltar.



Z. Mirco Ruaro, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 48% të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 24.000 leke në kapitalin themeltar.

Z. Pierluigi Poletti, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 2% të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 1.000 leke në kapitalin themeltar

7.2 Kapitali I Shoqerise perbehet teresisht nga kontribute ne para dhe zoterohet nga 3 ortakët e shoqerise.

7.3 Kuotat me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe pas ushtrimit te se drejtes se parablerjes ndaj ortakeve te tjere te Shoqerise, jane lirisht te transferueshme tek cdo individ ose person juridik nepermjet kontrates se shitblerjes, trashegimise, dhurimit ose nepermjet cdo menyre tjeter dhe forme te parashikuar nga ligji.

NENI 8

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit

8.1 Zmadhimi I kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas nenit 13 te ketij Statuti.

Zmadhimi I kpitalit mund te behet me derdhje ne para ose me kontribut ne natyre. Ne cdo rast keto Kontribute duhet te shoqerohen me nje certificate per nenshkrimin e tyre ose nje raport vleresimi te kryer nga nje ekspert I vleresimit te kontributeve ne natyre.

8.2 Zvogelimi I kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve me propozim te administrator/eve, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe te bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Asamblese se Pergjithshme vendos per zvogelimin e kapitalit sipas nenit 13 te ketij Statuti.

NENI 9

Transferimi I kuotave

9.1 Transferimii I kuotave te kapitalit te shoqerise mund te behen me shitje, trashegimi, dhurim, ose cdo menyre tjeter te parashikur nga Ligji. Nese njeri nga ortakët vendos transferimin e kuotave te tij, perparesi ne blerjen e ketyre kuotave dhe mundesne te paret do ta kene ortakët e tjere te kesaj shoqerise.


9.2 Transferimii I kuotave te kapitalit tek te tretet behet me vendim te ortakeve.

NENI 10

Organet e Shoqerise

10.1 Organet e Shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme
- b) Administrator/et





NENI 11

Asambleja e Pergjithshme

- 11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me I larte vendimarres I Shoqerise dhe merr Vendime kur eshte mbledhur rregullisht.
- 11.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme , e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyrueshme.
- 11.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet parashikuara nga ky statut , nga Lgji per Shoqerite Tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e iteresave te Shoqerise.
- 11.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e shoqerise , ose ne cdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin ne mbledhje. Njoftimi per mbledhje I dergohet me shkrim ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes.
- 11.5 Mbledhja e asamblese se Pergjithshme thirret nga Administrator/et. Thirrja e asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet dhe nga ortaket e Shoqerise.
- 11.6 Asambleja e Pergjithshme therret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

NENI 12

Asambleja e Zakonshme

- 12.1 Asambleja e zakonshme mblidhet cdo vit Brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit te administratoreve, pasqyrave financiare, dhe llogarive vjetore.
- 12.2 Vendimet e zakonshme merren nga ortaket e shoqerise.
- 12.3 Nese nuk arrihet marrja e vendimit sipaspikes 13.2 Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

NENI 13

Asambleja e Jashtezakonshme

- 13.1 Asambleja e Pergjithsme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve me interest e Shoqerse.
- 13.2 Vendimet qe kane te bene me (por pa u kufifuar ne to) ndryshimin e ketij statute, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, ndryshiin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, ndarjen e fitimeve, Prishjen e shoqerise, konsiderohen vendime te jashtezakonshme.
- 13.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga ortaket e shoqerise.

NENI 14

Pjesemarrja , votimi dhe Perfaqesimi

14.1 Ortaket e Shoqerise kane te drejten e pjesmarrjes dhe votimit ne Mbledhen e Asamblese se Pergjithshme; Votat e disponuara prej tyre jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.

14.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse arrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave

14.3 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

14.4 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve ose me perfaqesim nga nje person i trete i autorizuar prej tij. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme , e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese , me te njejtin rend dite.

Neni 15

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

15.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per;

- a) percaktimin e politikave tregtare
- b) Ndryshimin e Statutit
- c) Emerimin dhe shkartimin e administrator/eve dhe caktimin e shperblimit e tyre.
- d) Emerimin dhe likuidimin e likujdatoreve eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret , perfshire pergatitjen e pasqyrave finaciare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Miratimin e pasqyrave finaciare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) Miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit t Shoqerise;
- h) Pjestimin e kuotavedhe anullimin e tyre;
- i) Perfaqesimin shoqerise ne Gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administrator/eve;
- j) Shperndarjn e fitimeve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) Miratimin e rregullave procedurale te Mbledhjes se Asamblese;
- m) Ceshtje tjetere te caktuar nga Ligji ose nga ky Statut

Neni 16

Administratori/et

16.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.. Administratori i Shoqërisë **AGENZIA MIR Sh.p.k.** do të jetë;

- Ilaria Nurchi qytetare italiane , lindur ne Rome me 23 tetor 1967 me banim ne Treviso , rruga Via Luigi Santorio 5, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar me karte identiteti italiane nr. YA 87123394, ne cilesine e ortakut te shoqerise AGENZIA MIR



NENI 17.

Kompetencat e Administrator/eve

Administratori i Shoqërise do të përfaqësohet përpara ç' do organi administrativ, gjyqësor, apo ç' do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Administratori i Shoqërise ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratimin;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
7. raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

NENI 19.

Likuidimi i shoqërisë

19.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

19.2 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 20.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

20.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e

këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 21. Bilancet

21.1 Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 22. Shpërndarja e aktiveve

22.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Bisnesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 23. Baza Ligjore

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit. Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 24. Ndryshimet

24.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe ose të shfuqizohet pjesërisht ose I teri dhe të zevendesohet me një statut të tjetër të Asamblese se Përgjithshme.

24.2 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe ate italiane , me vlerë të njejtë secila.

Nenshkruhet sot me date 23.02.2024;

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE

Zj. Ilaria Nurchi

Z. Mirco Ruaro

Z. Pierluigi Poletti

PIERLUIGI POLETTI

ILARIA NURCHI

MIRCO RUARO

Jeanine Kue

Pierluigi Poletti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTËR FLORIAN F. HOXHA



DATE 23/02/2024
NR REP 270



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 23/02/ 2024 (Dymije e njezet e kater), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: ILARIA NURCHI, atësia Giovanni amësia MariaRosa shtetase Italiane, lindur në ROME dhe banues në ITALIA, me adresë Treviso, Via Luigi Santorio 5, Itali, lindur më 23/10/1967, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. YA87123394 dhe nr. personal YA87123394.

NËNSHKRUES/IT: MIRCO RUARO, atësia Iginio, amësia Ivona, shtetas Italian, lindur në Schio dhe banues në Italia, me adresë Via Carlo Forlanini, Nr.23 Valdagno, lindur më 22/06/1960, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. YA8303997 dhe nr. personal YA8303997.

NËNSHKRUES/IT: Pierluigi Poletti, atësia Antonio, amësia Bruna, shtetas Italian, lindur në Milano (MI) dhe banues në Pavia, me adresë Via F. Crispi, 200, 27047 Santa Maria Della Versa, Pavia, lindur më 27/12/1949, gjendja civile "i Martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. YB7530828 dhe nr. personal YB7530828.

Shtetasit e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, **ne prezence te perkthyeses se gjuhes italiane "Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise "AGENZIA MIR" shpk", bashkëlidhur.**

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
FLORIAN F. HOXHA



**ATTO DI FONDAZIONE
DELLA SOCIETA A RESPONSABILITA LIMITATA
“AGENZIA MIR S.R.L”**

A Durazzo oggi, in data 23.02.2024 (duemillaventiquattro), i soci:

1. Ilaria Nurchi cittadino italiano, nato a Roma il 23 Ottobre 1967 e resedento a Via Luigi Santorio 5, Treviso, Italia maggiorenno con piena capacità di agire, identificato tramite il carta identita Italiana numero YA 87123394 in qualità di socio della società che in seguito verrà denominata AGENZIA MIR Sh.p.k
2. Mirco Ruaro , cittadino italiano, nato a Schio, il 22 giugno 1960 e resedento a Via Carlo Forlanini, N.23 Valdagno Italia , maggiorenno con piena capacità di agire, identificato tramite il passaporto numero YA 8303997 in qualità di socio della società che in seguito verrà denominata AGENZIA MIR Sh.p.k
3. Pierluigi Poletti cittadino italiano, nato a Milano il 27 Dicembre 1949 e resedento a Via Francesco Crispi 200, Santa Maria della Versa Italia, maggiorenno con piena capacità di agire, identificato tramite il passaporto numero YB 7530828 in qualità di socio della società che in seguito verrà denominata AGENZIA MIR Sh.p.k

che firmeranno l'atto costitutivo con i seguenti termini;

ARTICOLO 1

Denominazione e forma della società'

1.1.E' costituita una Società a responsabilita limitata. Il nome della società “AGENZIA MIR S.R.L” e che seguito sara nominate “la società”.

ARTICOLO 2

La Costituzione

2.1 La società viene fondata secondo la legge n.9901 del 14.08.2008 “ Per I Commercianti e le Società commerciali” ed acquisisce personalita giuridica dal momento di registrazione al Registro Commerciale presso il Centro Nazionale del Registro.

2.2 La società svolge la sua attività in base alla legislazione Albanese, allo Statuto e al atto di costituzione.

ARTICOLO 3

La Sede

3.1 La sede legale della società è : Durazzo, Lagja nr.17, Spitalle , trovandosi in Z.C. 8517, nr.173/217.

3.2 La società secondo il verdetto degli soci può deliberare a l'istituzione o alla soressione di uffici amministrativi , finali in qualunque localita della Repubblica d'Albania o all'estero, così come l'istituzione o la soppressione di uffici vari, diversi alla sede sociale dentro il territorio d'Albania.

ARTICOLO 4

L'oggetto sociale

4.1 La società svolgerà la sua attività come segue:

La società ha per pgggetto la confezione e vendita di articoli di vestiario di qualunque tipo e pregio, compresi quelli di rnaglieria esterna, camiceria, accessori d'abigliamento e biancheria intima. Fasonista

